



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:081642

Data: 30.07.2019

Numri i dokumentit: 00434706

P.nr.274/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit L..Sh... nga Gj..., për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 i KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.431/2019, të datës 20.03.2019, jashtë seancës gjyqësore, me datë 30.07.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim me numër..., e datës 29.07.2019, e lidhur në mes të pandehurit L... Sh... nga Gj... dhe të dëmtuarës..., e arritur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gj.
- II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.II.nr.431/2019, e datës 20.03.2019 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të ....nga Gj..., për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 i KPRK-ës, për shkak se i pandehuri dhe e dëmtuara kanë arritur marrëveshjen për ndërmjetësim. p
- III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 21.03.2019, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.431/2019, kundër të pandehurit ....nga Gj, për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 i KPRK-ës.

Më datë 26.07.2019, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit dhe i pandehuri, me çrast pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benefitete dhe pasojat e procedurës së ndërmjetësimit i pandehuri ka deklaruar se dëshiron që kjo çështje penale të zgjidhet në këtë procedurës, propozim ky i cili është mbështetur edhe nga ana e prokurorit të shtetit.

Me datë 29.07.2019, pranë zyrës për ndërmjetësim në këtë gjykatë është arritur marrëveshja me numërr Nd....., sipas të cilës i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe një kohësisht të dëmtuarës ....., i ka bërë kompenzimit e dëmit të shkaktuar si pasojë e veprimeve të tij ndërsa e dëmtuara pas kompensimit të dëmit nga ana e të pandehurit ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurit dhe se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike ndaj tij sepse kompenzimin e dëmit tanimë e kanë realizuar.

Numri i lëndës: 2019:081642  
Datë: 30.07.2019  
Numri i dokumentit: 00434706

Andaj gjykata duke u bazuar në të lartcekurat si dhe në bazë të nenit 358 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe paragrafi 2 të KPP-së dhe nenit 2, 4, 8, 14, të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.274/2019, me datë 30.07.2019

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

Numri i lëndës: 2019:081642

Datë: 30.07.2019

Numri i dokumentit: 00434706

**2019:081642, 30.07.2019**

Numri i lëndës: 2019:081642

Datë: 30.07.2019

Numri i dokumentit: 00434706

---

Rilind Sermaxhaj